



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Empowered lives.
Resilient nations.

Udhëzime operative
për Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
për paraqitjen e interesimit për pjesëmarrje në projektin

"Fuqizimi i Këshillave Komunale"

Skema e Granteve Komunale (SGK) 2019-2020

Shtator 2019

PËRMBAJTJE

Hyrje

1. Cili është qëllimi kryesor i projektit?
2. Kush mund të paraqet interesim për pjesëmarrje në këtë projekt?
 - 2.1. Kush nuk mund të paraqet interesim për pjesëmarrje në këtë projekt?
 - 2.2. Çështje të tjera që lidhen me pranueshmërinë e aplikacioneve
3. Sa është kohëzgjatja e projektit?
4. Cili është afati kohor për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara?
5. Përfitimi financiar dhe jo-financiar për pjesëmarrësit e projektit?
6. Bashkëfinancimi nga ana e komunave
7. Shpenzimet që nuk mbulohen nga projekti
8. Ku duhet ta dorëzoni aplikimin dhe afatin e dorëzimit?
9. Vlerësimi i aplikacioneve dhe përzgjedhja e komunave
10. Si është organizuar procedura e vlerësimit dhe e përzgjedhjes?
11. Kriteret e vlerësimit
 - 11.1. Kriteret për përmbushjen e kushteve
 - 11.2. Kriteret e përzgjedhjes
 - 11.3. Kriteret shtesë
12. Lidhja e marrëveshjeve

Hyrje

Hulumtimet fillestare dhe analizat e bëra nga ana e UNDP-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare përmes metodave të ndryshme të hulumtimit, kanë treguar se statusi, puna dhe efikasiteti i këshillave komunale nuk i plotësojnë pritjet ligjore dhe praktike. Përkatësisht, anëtarët e zgjedhur të këshillave komunale nuk posedojnë njohuri paraprake dhe gatishmëri të nevojshme për t'iu përgjigjur detyrave dhe sfidave që i kanë përpara.

Nga ana tjetër, këshilltarët komunal, megjithëse janë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta për të përfaqësuar qytetarët dhe interesat e tyre, ata shumë rrallë kanë ndërveprim të drejtpërdrejtë me zgjedhësit e tyre, ndërsa kontaktet dhe lidhja me këshilltarët nga komunat e tjera si mënyrë e komunikimit dhe përkrahjes reciproke pothuajse nuk ekzistojnë.

Në të njëjtën kohë, planifikimi dhe buxhetimi zakonisht bëhet nga administrata komunale, me ç'rast këshilltarët kryesisht në masë të madhe janë në rolin e vëzhguesve. Në këtë mënyrë, prioritetet për shpenzimin e fondeve komunale nuk janë subjekt i përfshirjes aktive dhe mbikëqyrjes publike. Mund të konkludojmë se këshillat komunale janë pjesë e një pasqyre më të madhe sociale në të cilën institucionet qeveritare në të gjitha nivelet dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre për avancimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave dhe të nxisin kohezionin në një shoqëri të larmishme dhe multietnike. Kuotat për listat zgjedhore kanë kontribuar në përfaqësimin e grave në këshillat lokale përafërsisht në një të tretën e të gjithë anëtarësisë, por çështjet e barazisë së burrave dhe grave ende rrallë vërehen në debatet e këshillave ose në vendimet për shpërndarjen e shpenzimeve të komunave. Këshilla të vogla në shtet kanë gra kryetare, ndërsa funksionet ekzekutive kryesisht janë të plotësuara nga burrat. Vendimet për shpenzimin e fondeve komunale shpesh miratohen pa i marrë parasysh nevojat specifike të komuniteteve të ndryshme etnike.

Me qëllim të tejkalimit të mangësive të mësipërme, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetje dhe ndihmë financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), po zbaton projektin "Fuqizimi i këshillave komunale".

Qëllimi i projektit është rivitalizimi i këshillave komunale dhe fuqizimi i rolit të tyre në trekëndëshin lokal të pushtetit, duke ofruar njohuri të reja për anëtarët e këshillave komunale, mbështetje përmes rrjetëzimit të këshilltarëve nga të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë dhe më gjerë, si dhe mbështetje në lehtësimin e komunikimit midis komunitetit dhe këshillave si një mënyrë për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien e pushtetit lokal.

Që të arrihen rezultatet e pritshme të projektit, aktivitetet do të zbatohen në tre komponente të veçanta:

Komponenti 1 - Fuqizimi përmes zhvillimit të kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të komunave bazuar në metodologjitë tradicionale dhe inovative;

Komponenti 2 - Fuqizimi i këshillave të komunave përmes mbështetjes financiare (grante të vogla) për aktivitetet prioritare të komunave të përzgjedhura në bazë të konsultimeve publike; dhe

Komponenti 3 - Fuqizimi përmes rrjetëzimit, kodifikimit, institucionalizimit dhe qëndrueshmërisë.

Për kohëzgjatjen e projektit 2016-2020, gjithsej 24 komuna do të përfshihen drejtpërdrejtë në zbatimin e projektit. Që nga gushti i vitit 2016, deri tani në këtë projekt marrin pjesë pesëmbëdhjetë komuna¹ të cilat janë përzgjedhur në kuadër të fazës përgatitore të projektit në vitin 2015, si dhe në thirrjen e parë publike të realizuar në vitin 2018. Këto komuna u përzgjedhën përmes krijimit të një

¹ Strumicë, Vallandovë, Sveti Nikole, Çair, Veles, Ohër, Kumanovë, Brvenicë, Strugë, Gostivar, Zhelinë, Qendër, Kavadar, Koçani and Mogila

mostre të llojeve të ndryshme të komunave dhe të njëjtit i përfshijnë komunat urbane dhe rurale, numrin e ndryshëm të banorëve, komunat nga rajone të ndryshme, komunat e qeverisura nga pozita dhe opozita, komunat me raporte negative të auditimit, komunat me llogari të bllokuara, etj.

Nëpërmjet kësaj thirrjeje për shprehjen e interesimit për pjesëmarrje në projektin "Fuqizimi i Këshillave Komunale", do të përzgjidhen 9 komuna të reja të cilat do të përfshihen në projektin nga nëntori i vitit 2019.

Këto udhëzime operative i ofrojnë procedurat dhe kriteret thelbësore për përzgjedhjen dhe pjesëmarrjen në projektin e UNDP-së "Fuqizimi i Këshillave Komunale".

1. Cili është qëllimi kryesor i projektit?

Qëllimi kryesor i projektit "Fuqizimi i Këshillave Komunale" është t'ju ofrojë përkrahje këshillave komunale për t'u bërë organe më efektive dhe autonome, për të trajtuar më mirë ndikimin e ekzekutivit, përmes përbushjes adekuate të rolit të vet kushtetues të legjislacionit, mbikëqyrjes dhe avokimit. Si përgjigje, këto përpjekje do të rrisin transparencën dhe llogaridhënien e Kryetarit të Komunës ndaj Këshillit dhe të Komunës ndaj qytetarëve, dhe do të përmirësohen kushtet e jetesës në komunitetin lokal përmes zbatimit të suksesshëm të projekteve prioritare të komunitetit.

2. Kush mund të paraqet interesimin për pjesëmarrje në këtë projekt?

Në këtë thirrje, mund të paraqesin interesimin të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, përveç komunave që aktualisht marrin pjesë në këtë projekt.

2.1. Kush nuk mund të paraqet interesimin për pjesëmarrje në këtë projekt?

Në këtë thirrje nuk mund të paraqesin interesimin personat e tjerë juridikë dhe fizikë që nuk kanë statusin e njësisë së vetëqeverisjes lokale.

2.2. Çështje të tjera që lidhen me përgatitjen e aplikacioneve

Një komunë mund të paraqesë vetëm një aplikim. Vetëm komunat e përzgjedhura do të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi dhe një Marrëveshje me Zyrën e UNDP-së.

Aplikimit i bashkangjitet edhe një Letër për angazhimin (Aneksi 1 i aplikacionit) me nënshkrimin e kryetarit të këshillit të komunës dhe të kryetarit të komunës dhe vulën e komunës, mes tjerash, edhe për respektimin e objektivave të projektit dhe të parimeve për transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë gjatë zbatimit të projektit.

3. Sa është kohëzgjatja e projektit?

Kohëzgjatja e aktiviteteve me nëntë komunat e reja të përzgjedhura është 14 muaj, dhe të njëjtat janë planifikuar të fillojnë me zbatimin në muajin nëntor të vitit 2019, dhe të përfundojnë në muajin dhjetor të vitit 2020.

4. Cila është korniza kohore për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara?

Aktivitetet individuale me komunat e përzgjedhura do të realizohen në dy faza, edhe atë në:

- në fazën e parë (**në periudhën nëntor 2019 - qershor 2020**), do të zbatohen aktivitetet e parapara për fuqizimin e kapaciteteve të anëtarëve të këshillave të Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (NjVL) përmes realizimit të Programit për zhvillimin e kapaciteteve, rrjetëzimit të këshilltarëve dhe përzgjedhjes të projekteve prioritare të komunitetit përmes pjesëmarrjes participative (forume në komunitete),
- në fazën e dytë (**në periudhën qershor-dhjetor 2020**), do të realizohen projektet prioritare të komunitetit të përzgjedhur përmes një qasjeje participative.

5. Përfitimet nga pjesëmarrja në këtë projekt

Komunat që do të përzgjidhen për pjesëmarrje në këtë projekt do të marrin disa përfitime jo-financiare si dhe përfitime financiare.

Në kuadër të përfitimeve jo-financiare, anëtarët e Këshillave të komunave të përzgjedhura do të përfitojnë mundësi për pjesëmarrje në trajnime, në ngjarje këshillimore, në seminare dhe në konferenca, si dhe në vizita studimore. Në të njëjtën kohë, këshillat dhe komunat do të kenë mundësinë të marrin pjesë në aktivitete për Fuqizimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare. Përfitimet e lartpërmendura do t'ju ndihmojnë këshilltarëve për t'i forcuar kapacitetet e tyre për kryerje më të suksesshme të kompetencave të tyre.

Brenda përfitimeve financiare, komunat do të marrin fonde në shumën totale prej **62.000 USD**, më saktësisht:

- **12.000 USD** për përfshirjen e të paktën një iniciative të re për transparencë dhe pjesëmarrje qytetare, dhe
- **50.000 USD** për realizimin e 1 deri 3 projekteve prioritare për komunitetin të përzgjedhur përmes qasjes participative - përdorimi i metodologjisë për zbatimin e forumeve në komunitete.

6. Bashkëfinancimi nga ana e komunave

Bashkëfinancimi nga ana e komunave për pjesëmarrje në këtë projekt nuk kërkohet. Në të njëjtën kohë, financimi i pjesshëm i projekteve prioritare komunale nuk do të pranohet. Do të bëhen të gjitha përpjekjet që të sigurohet mbështetja financiare e komunave, të koordinohet me planet ekzistuese të komunale për investime dhe iniciativat paralele komunale që e mbështesin mbrojtjen sociale dhe qëllimet e ngjashme.

Një parakusht dhe implikim i vetëm financiar për komunat për pjesëmarrje në këtë projekt është mbulimi i kostos për angazhimin e moderatorit / moderatores të / së licencuar të forumeve në komunitete ose të forumeve buxhetore.

7. Shpenzimet që nuk mbulojnë nga projekti

Shpenzimet e listuara më poshtë nuk mbulojnë nga fondet që do t'i fitojnë komunat që do të përzgjidhen për pjesëmarrje në këtë projekt:

- shpenzimet për TVSH

- rrogat për nëpunësit shtetëror dhe të punësuarit në komunat
- tatimi personal për personat të cilët janë të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve projektuese

8. Ku duhet t'a dorëzoni aplikimin dhe afatin për dorëzim?

Komunat që do të paraqesin interesimin për pjesëmarrje në këtë projekt, duhet të dorëzojnë një dosje të plotë në përputhje me Udhëzimet Operative dhe Kërkesat të përmbajtura në Aplikacionin. Aplikacioni plotësohet dhe dorëzohet në gjuhën angleze. Një origjinal dhe dy kopje të dosjes së plotë të aplikimit (me anekset) në gjuhën angleze, një version elektronik i Aplikacionit në USB, si dhe një kopje të aplikacionit në gjuhën maqedonase (gjegjesisht, në gjuhët zyrtare të komunës aplikuese) në adresën e mëposhtme:

Zyra e UNDP-së – Projekti “Fuqizimi i këshillave komunale”
rr. Jordan Haxhi Konstantinov - Xhinot, nr. 23, Shkup.

Personat për kontakt: Lejla Nebiu Sulejmani, tel. 071 393 628 dhe Vencislava Llazarevska, tel. 070 477 516.

Në mënyrën që aplikacionet të vlerësohen për pranim, ato duhet të merren në dorë, përmes postës ose përmes korrierit në adresën e mësipërme jo më vonë se **10 tetor të vitit 2019 deri në orën 16:00**.

E RËNDËSISHME

Ju lutemi shkruani në zarfin: "*Aplikacioni _____ (deklaroni emrin e njësisë së vetëqeverisjes lokale)* për paraqitjen e interesimit për pjesëmarrje në projektin "Fuqizimi i Këshillave Komunale". Aplikacionet në asnjë mënyrë nuk duhet të dërgohen me faks ose me e-mail. Asnjë aplikim nuk do të pranohet pas skadimit të afatit.

9. Vlerësimi i aplikacioneve dhe përzgjedhja e komunave

Vlerësimin dhe përzgjedhjen e 9 komunave të reja që do të marrin pjesë në këtë projekt në periudhën e viteve 2019-2020, do të kryhet nga një ekip i vlerësimit dhe përzgjedhjes i përbërë nga përfaqësues të UNDP-së dhe SDC-së. Lista me komunat e përzgjedhura do të rishikohet dhe konfirmohet nga Komiteti Këshilldhënës i projektit në të cilin marrin pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale (MVL), Ministrisë së Financave (MF), Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNjVL) dhe SDC-së.

Vlerësimi i propozimeve bëhet në **dy faza**.

- **Faza e para-përzgjedhjes:** Kjo është faza e parë në procesin e vlerësimit. Përbëhet nga kontrollimi i aplikacioneve të pranuar për përmbushjen e kushteve, bazuar në listën e kritereve për përmbushjen e kushteve (shiko 11.1).
- **Faza e përzgjedhjes:** Aplikimet që do të kalojnë fazën e para-përzgjedhjes, vazhdojnë me kontrollimin e kritereve për përzgjedhje, bazuar në tabelën e vlerësimit (shiko 11.2). Ekipi i vlerësimit i vlerëson aplikimet duke dhënë pika për disa pyetje të caktuara, gjegjesisht, kritere për përzgjedhje.

10. Si është organizuar procedura e vlerësimit dhe përzgjedhjes?

- UNDP i regjistron të gjitha aplikacionet që arrijnë.
- Anëtarët e ekipit të vlerësimit dhe përzgjedhjes nënshkruajnë një letër për paanshmëri para fillimit të procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes.
- Ekipi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së komunave është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve në aspektin e pranueshmërisë administrative (përbushja e kërkesave) dhe për vlerësimin e cilësisë teknike të aplikacioneve.
- Ekipi i vlerësimit dhe përzgjedhjes i komunave vlerëson çdo aplikacion në bazë të kriterëve për përbushjen e kushteve dhe kriterëve për përzgjedhje, mban një Procesverbal dhe i miraton rekomandimet dhe vendimet e veta në formë të një Raporti për vlerësim.
- Raporti i vlerësimit i dorëzohet Komitetit Këshilldhënës të projektit për shqyrtim dhe konfirmim.
- Ekipi i vlerësimit dhe përzgjedhjes i komunave ka të drejtë të takohet me komunat e propozuara për përzgjedhje për shqyrtimin dhe konfirmimin e të dhënave të specifikuara në aplikacionin.
- UNDP me shkrim do t'i njoftojë të gjithë aplikuesit për rezultatet e procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes.

11. Kriteret e vlerësimit

Ekipi i vlerësimit i shqyrton të gjitha aplikacionet e pranuar në përputhje me kriteret e përshkruara më poshtë. Vlerësimi i aplikacioneve bëhet në dy faza:

- Kriteret për përbushjen e kushteve, dhe
- Kriteret e përzgjedhjes.

11.1 Kriteret për përbushjen e kushteve

1. Nëse aplikuesi e ka statusin e një njësie të vetëqeverisjes lokale?
2. Nëse fletëparaqitja është e shoqëruar me një Letër Bashkëpunimi (aneksi i aplikimit) me nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit të Komunës dhe të Kryetarit të Komunës dhe vulën e komunës?
3. Nëse komuna që paraqet interesimin për pjesëmarrje në këtë projekt pranon për të mbuluar koston e kontraktuar të angazhimit të moderatorit / moderatores të / së licencuar të forumeve në bashkësi apo forumeve buxhetore?
4. Nëse komuna e cila paraqet interesimin për pjesëmarrje në projekt pranon që të instalohet dhe administrohet e-tabela kontrolluese në ueb-faqen komunale me të dhëna për ekzekutimin e buxhetit në baza tremujore dhe vjetore?
5. Nëse komuna e cila paraqet interesimin për pjesëmarrje në këtë projekt pranon në Statutin e vet t'i përfshijë "Forumet në Bashkësi" si një mekanizëm për pjesëmarrje / konsultim me qytetarët gjatë përzgjedhjes së projekteve prioritare të komunitetit? (nëse për momentin komuna nuk i ka përfshirë "Forumet në Bashkësi" në Statutin e vet)
6. Nëse janë plotësuar të gjitha pjesët e fletëparaqitjes?
7. Nëse është dorëzuar origjinali (i nënshkruar dhe i vulosur) dhe dy kopje të fletëparaqitjes?
8. Nëse është dorëzuar edhe versioni elektronik i fletëparaqitjes?
9. Nëse është përfshirë edhe një kopje e fletëparaqitjes në gjuhën zyrtare të komunës e cila e dorëzon fletëparaqitjen (në gjuhën maqedonase ose në gjuhën shqipe)?

E rëndësishme: Çdo aplikacion që nuk do të jap përgjigje pozitive (PO) për të gjitha kriteret e mësipërme për përmbushjen e kushteve, nuk do të merret parasysh për vlerësimin dhe përzgjedhjen e mëtejshme.

11.2 Kriteret e përzgjedhjes

Aplikimet që i kanë kaluar kriteret për përmbushjen e kushteve do të vlerësohen në bazë të kriterëve të përzgjedhjes sipas kriterëve dhe pikave të përcaktuara, siç përcaktohet më poshtë në kriteret e vlerësimit.

Numri maksimal i pikave që aplikantët mund t'i marrin është 100. Vetëm aplikacionet që kanë fituar së paku 70 pikë do të merren parasysh për përzgjedhje, sipas rankimit.

Kriteret e përzgjedhjes

	Pikat maksimale	Pyetje në aplikacion
A. Kalendar i qartë buxhetor dhe pasqyrë cilësore e buxhetit të propozuar - niveli i angazhimit të Komisionit për punë financiare dhe buxhet (KFB) dhe Këshillit komunal	20	2A
A1. Nëse në komunën tuaj është miratuar një Kalendar buxhetor nga Këshilli i Komunës?	3	A1
A2. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht procesin e përgatitjes të kalendarit buxhetor për vitin 2019 në NJVL-në tuaj	3	A2
A3. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht se në çfarë mënyre dhe në çfarë niveli është angazhuar Komisioni për punë financiare dhe buxhet në procesin e përgatitjes së kalendarit buxhetor për vitin 2019 në NJVL-në tuaj	6	A3
A4. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht në çfarë mënyre dhe në çfarë shkalle është angazhuar Këshilli i Komunës në procesin e përgatitjes së kalendarit buxhetor për vitin 2019 në NJVL-në tuaj	6	A4
A5. Ju lutemi përshkruani procesin e zbatimit të kalendarit buxhetor gjatë përgatitjes të Buxhetit të Komunës në vitin aktual për vitin e ardhshëm:	2	A5
B. Përpjekjet dhe mekanizmat ekzistuese për pjesëmarrje qytetare (Forumet e Komuniteteve dhe / ose mekanizma të tjerë)	20	2B
B1. Ju lutemi specifikoni format me të cilat e siguron pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje në komunën tuaj	4	B1
B2. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht shembullin e fundit për të cilin keni siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në komunën tuaj për iniciativat me interes për qytetarët, sektorin e biznesit, OJQ-të, grupet e marginalizuara dhe të prekshme dhe palët e tjera të interesuara	10	B2
B3. Nëse në komunën tuaj mbahen Forume në komunitete	2	B3

B4. Nëse mbahen, ju lutemi tregoni numrin e forumeve të mbajtura në periudhën janar 2015 - qershor 2019	4	B4
C. Ekzistimi i kuadrit për auditimin e brendshëm dhe ekzekutimin e tij	10	2B
C1. Ju lutemi tregoni numrin e auditimeve të brendshme të kryera në NJVL-në tuaj në periudhën janar 2015 - qershor 2019	3	B1
C2. Ju lutemi tregoni numrin e auditimeve të brendshme të kryera në subjektet e sektorit publik në nivelin e NJVL-së tuaj (komuna disponon me të drejtat themeluese) në periudhën prej janarit të vitit 2015 deri në qershor të vitit 2019	1	B2
C3. Nëse në komunën tuaj nuk ka auditor të brendshëm, ju lutemi përshkruani shkurtimisht në çfarë mënyre është bërë auditimi i brendshëm në NJVL-në tuaj, gjegjësisht, shpjegoni se në çfarë mënyre merrni këshilla për realizimin e objektivave të NJVL-së	3	B3
C4. Ju lutemi shënoni numrin e auditimeve të kryera të raporteve financiare në NJVL-në tuaj në periudhën janar të vitit 2015 – qershor të vitit 2019	3	B4
Ç. Shqyrtimi cilësor i raporteve financiare dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe monitorimi i përmirësimeve	10	2Ç
Ç1. Ju lutemi shpjegoni procesin e shqyrtimit të raporteve financiare (komuna, Ndërmarrja Publike (NP) dhe Drejtoria Publike (DP)I dhe subjektet e tjera të sektorit publik ku komuna ka të drejtat themeluese) dhe raportet e auditimit të brendshëm nga Këshilli Komunal dhe Komisionet kompetente	5	Ç1
Ç2. Ju lutemi përshkruani mekanizmat e përdorur nga Këshilli Komunal për monitorimin e përmirësimeve të propozuara me raportet financiare dhe raportet e auditimit	5	Ç2
D. Reagimi në lidhje me rekomandimet e Komisionit për mundësi të barabarta dhe Komisionit për marrëdhënie midis komuniteteve	10	2D
D1. Nëse në komunën tuaj ekziston një Komision për Mundësi të Barabarta mes Grave dhe Burrave	2	D1
D2. Nëse ekziston ky Komision, ju lutemi përshkruani se në çfarë mënyre Këshilli është i përfshirë në shqyrtimin e rekomandimeve të Komisionit	3	D2
D3. Nëse në komunën tuaj ekziston Komisioni për mundësi të barabarta mes komuniteteve	2	D3
D4. Nëse ekziston ky Komision, ju lutemi përshkruani se në çfarë mënyre Këshilli është i përfshirë në shqyrtimin e rekomandimeve të Komisionit	3	D4
DH. Gatishmëria për të instaluar dhe administruar e-tabelën kontrolluese të ueb-faqeve të komunave me të dhëna për ekzekutimin e buxhetit në baza tremujore dhe vjetore.	15	2DH

DH1. Ju lutemi përshkruani se në çfarë mënyre dhe ku komuna e juaj i publikon të dhënat për punën financiare dhe ekzekutimin e buxhetit dhe sa shpesh ato i përditëson (azhurnon)	6	DH1
DH2. Ju lutemi tregoni cilat mekanizma i përdor komuna e juaj për të forcuar transparencën e funksionimit të saj të përgjithshëm të punës	9	DH2
E. Çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e Këshillit të Komunës	15	2E
E1. Ju lutemi tregoni se çfarë lloj informacionesh dhe dokumentesh që kanë të bëjnë me punën e Këshillit të komunës tuaj janë publikisht në dispozicion	5	E1
E2. Ju lutemi tregoni mënyrat në të cilat anëtarët e këshillit të komunës komunikojnë me qytetarët	3	E2
E3. Nëse në komunën tuaj ekziston një afat i caktuar për takime midis anëtarëve të këshillit me qytetarët	2	E3
E4. Nëse ka një termin të caktuar, ju lutemi tregoni sa shpesh organizohen takimet	5	E4
Numri maksimal i përgjithshëm i pikave	100	

11.3 Kriteret shtesë

Nëse kriteret e përzgjedhjes i plotësojnë më shumë se 9 komuna, do të zbatohen kriteret shtesë të përzgjedhjes, përmes të cilave do të arrihet ekuilibri maksimal ndërmjet aspekteve gjeografike, etnike, gjinore dhe politike të NJVL-së, statusi arsimor dhe profesional i këshilltarëve, si dhe kapaciteti financiar dhe kadrovik i komunave të cilat do të përzgjidhen për pjesëmarrje në këtë projekt.

12. Lidhja e marrëveshjeve

UNDP e përgatit Memorandumin për mirëkuptim dhe Marrëveshjen për bashkëpunim me çka më detajisht rregullohen të drejtat dhe detyrimet ndërmjet UNDP-së dhe komunave të përzgjedhura. Gjuha e marrëveshjeve për bashkëpunim projektues është gjuha angleze. Fillimi zyrtar i zbatimit të aktiviteteve projektuese është muaji nëntor i vitit 2019.